



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më dt. 27.5.2024, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi – Rexha, Faton Marrolli, Kimeta Shok, Oktay Kurtesh, Triera Kasumi Berisha.

Mungoi: Adnan Ajeti.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Betim Abdullahu - u.d. udhëheqës si ZKKK-ës, Qefsere Berisha Veseli - zyrtare në ZKKK, Klaudia Mula - zyrtare për komunitete në ZKKK, Daniele Melai- LMT, Arianita Beqa Raci - UNMIK, Fisnik Dida - OSBE.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

## R E N D D I T E

1. Shqyrimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit znj. Jehona Lushaku Sadriu: (a) të na informojë se si ka shkuar procesi mësimor në vitin shkollor 2023/2024, b) a ka pasur probleme me teskte shkollore për nxënësit e komuniteteve joshumicë, a ka pasur braktisje të shkollës në pjesët ku jetojnë komunitetet joshumicë, mungesë të mësimdhënësve etj.);
3. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Bekim Breštovci, (informim rreth sfidave në regjione ku jetojnë komunitetet joshumicë, koordinimi i përbashkët për aktivitete gjatë vitit 2024);
4. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Inspepcionit z. Florian Dushi, a) deponitë ilegale, b) ndërtimi i egër;
5. Raportim i Komisionit nga vizita e komuniteteve joshumicë në Bërnice të Ulët, Bërnice të Epërme, Bardhosh, Slivovë, Besi dhe Lebanë;
6. Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale znj. Adelinë Sahiti, të na njoftojë lidhur me numrin e rasteve sociale nga komunitetet joshumicë (serb, ashkali, goran, turq, boshnjak, rom);

Faqe 1 nga 5

7. Përparim i bashkëpunimit të ZKKK-ës me anëtarët e Komitetit për Komunitete;
8. Raporti i ZKKK-ës për muajin prill 2024;
9. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
10. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

#### Pika e parë

##### Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

#### Pika e dytë

Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Arsimit znj. Jehona Lushaku Sadriu: (a) të na informojë se si ka shkuar procesi mësimor në vitin shkollor 2023/2024, b) a ka pasur probleme me tekste shkollore për nxënësit e komuniteteve joshumicë, a ka pasur braktisje të shkollës në pjesët ku jetojnë komunitetet joshumicë, mungesë të mësimdhënësve etj.) Për shkak të mosmundësisë së pjesëmarrjes së drejtoreshës së arsimit znj. Jehona Lushaku Sadriu, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

#### Pika e tretë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z. Bekim Brestovci, (informim rreth sfidave në regjione ku jetojnë komunitetet joshumicë, koordinimi i përbashkët për aktivitete gjatë vitit 2024).

Po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

#### Pika e katërt

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Inspepcionit z. Florian Dushi, a) deponimet ilegale, b) ndërtimi i egër

Njëherazi edhe kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

#### Pika e pestë

Raportim i Komisionit nga vizita e komuniteteve joshumicë në Bërnicë të Ulët, Bërnicë të Epërme, Bardhosh, Slivovë, Besi dhe Lebanë.

**Mirsada Behluli** – sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se raportin e keni marrë të gjithë, atëherë fjalën ia kaloj Nenadit nëse ka të shtojë diçka lidhur me këtë pikë.

**Nenad Miladinovic** – lidhur me raportin e Komisionit nga vizita komuniteteve joshumicë tha se nuk do i përsëris prapë pasi të gjithatë dhënat i keni në raport dhe i keni lexuar të gjithë. Ai në vazhdim tha se kryesisht më së shumti probleme ka pasur në Bërnicë të Poshtme se vërtet ka shumëçka rreth infrastrukturës që mund të bëhet për t'u zgjidhur problemet e mëdha duke cekur vërshimet, nga të

reshurat e shumta në ç'rast po shkaktojnë dëme te disa shtëpi. Gjithashtu tha se në raport është cekur edhe pastrimi dhe sanimi i shtratit të lumit, si dhe problemi i cili gjithnjë ceket është deponia ilegale, të cilën mund ta vërtetojnë edhe përfaqësuesit që kanë qenë në vizitë, përfaqësuesit e ZKKK-ës, OSBE-s, UNMIK-t. Ai mes tjerash tha se unë së bashku me Sllavicën kemi vizituar kishën dhe kemi një kërkesë të cilën keni mundur ta shihni në raport. Bëhet fjalë për vendparkimin para kishës, i cili është lejuar të shfrytëzohet si parking për qytetarët të cilët jetojnë aty si dhe ata në afërsi. Në këtë rast kisha ka kërkuar që parkingu të shtrohet në pllaka, ku ekziston edhe shkresa zyrtare tek kryetari Rama për rregullimin e këtij parkingu.

#### **Pika e gjashtë**

**Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale znj. Adelinë Sahiti, të na njoftojë lidhur me numrin e rasteve sociale nga komunitetet joshumicë (serb, ashkali, goran, turq, boshnjak, rom).**

Po ashtu edhe kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njëren nga mbledhjet e radhës.

#### **Pika e shtatë**

#### **Përparim i bashkëpunimit të ZKKK-ës me anëtarët e Komitetit për Komunitete**

**Nenad Miladinovic** - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se ne gjithmonë kemi pasur bashkëpunim të mirë me ZKKK-në dhe shpresojmë të vazhdojë kështu.

**Mirsada Behluli** – sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se bashkëpunimi në mes të ZKKK-ës dhe Komitetit për Komunitete është i mirë duke u bazuar në raportet periodike që i pranojmë. Ajo në vazhdim tha se përveç raporteve nga ZKKK, ne marrim edhe të gjitha informatat aktuale të cilat janë për atë muaj. Njëzëri mund të themi se jemi të kënaqur me bashkëpunimin e ZKKK-ës dhe Komitetit për Komunitete.

**Betim Abdullahu** – shprehu shqetësimin lidhur me varrezat e serbëve dhe katolikëve që janë në Dragodan, e që komuna në atë pjesë do të punojë në zgjerimin e rruqës, gjegjësisht lidhjen e rrethit të madh me lagjen Dragodan. Ai në vazhdim tha se pasi që e kanë zgjedhur problemin me hekurudhën, Komuna e Prishtinës i ka përcaktuar pikat e veta të pronës publike, rrëthoja ekzistuese që ka qenë tek varrezat ka dalë pjesë e hekurudhës ku deri tek rrëthoja vjen pjesa e urës. Tëtje tha se pas njoftimit nga drejtori i investimeve kapitale kemi dal në terren unë, Nenadi dhe prifti i Kishës, së bashku me drejtorin dhe inxhinierët të cilët janë të kyçur në këtë projekt dhe i kemi njoftuar se nuk ka ndonjë tendencë për me lëvizë diçka meqë rrëthoja do të largohet pak brenda varrezave. Ai të pranishmit i njoftoi se i njëjti raport i është dërguar edhe OSBE-s, USAID-it, së bashku me skemën se si do të bëhet largimi i rrëthojës. Në fund tha se zyra e jonë ka hapur fushatën për regjistrimin falas të komunitetit RAE, së bashku me Drejtorinë e Administratës. Kjo fushatë ka filluar nga 15 prilli deri më 15 maj, nuk kemi ende asnjë raport nga Drejtoria e Administratës nga shërbimi i ofiqarisë se sa persona janë regjistruar.

**Nenad Miladinovic** - e falënderoi Betimin për prezantimin korrekt për projektin i cili kalon rrith varrezave, por shprehu shqetësimin që prifti nuk është informuar me kohë për atë që po bëhet, por pavarësisht disa keqkuptimeve tha se nuk kemi pasur probleme.

#### Pika e nëntë

**Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre.**

**Nenad Miladinovic** – tha se nuk kisha shtuar diçka të veçantë, por e kisha cekur problemin me vërvshime nga të reshorat pasi që shumë familje kanë pasur dëme të mëdha, ku të gjithë kanë ardhur tek unë në që të ankohen sepse vijnë në komunë, por askush nuk i pranon në takim dhe nuk ju pranojnë asnjë kërkesë.

**Mirsada Behluli** – sa i përket gjendjes së sigurisë të komunitetit boshnjak tha se nuk ka kurrrfarë problemesh.

**Triera Kasumi Berisha** - tha se kam një rekomandim për z. Nenad, komuna ka mekanizma ku pranohen kërkesat si ato urgjente ashtu edhe ato që kanë të bëjnë me vërvshimet, pasi që ekziston rregullativa ligjore të ketë komisione dhe për çështje të tilla t'i drejtohen komisioneve.

**Nenad Miladinovic** – duke iu përgjigjur znj. Kasumi Berisha tha se e di shumë mirë se ekziston komisioni, është komisioni në Drejtoren e Shërbimeve Publike me të cilët edhe komunikoj, mirëpo kur njerëzit nuk janë të informuar ata vijnë në komunë.

#### Pika e dhjetë

##### Të ndryshme

**Mirsada Behluli** – tha se e kam vërejtur se të gjithë e kanë dorëzuar listën me emra dhe mbiemra të komuniteteve joshumicë që janë raste sociale, për dru zjarri. Në përgjithësi janë 155 familje ku nga komuniteti rom janë pesë (5), ashkali janë njëqind e dhjetë (110), nga komuniteti boshnjak janë katër (4), goran janë tetë (8), nga komuniteti turk janë tridhjetë e pesë (35) dhe nga komuniteti serb janë njëzet e tetë (28). Ajo në vazhdim tha se më vjen mirë që listat i keni dorëzuar më herët, sepse mendoj se asamblistet tona Ema dhe Triera së bashku me ZKKK-në mund të interesohen më herët për t'i mbuluar këto familje, sepse në vitin 2023 ka qenë ky problem pasi që me vonesë ka nisur ky aksion dhe nuk është bërë asgjë. Pasi që nga 175 familje në vitin 2023, ndihmë kanë marrë vetëm 70 familje që i bie 105 familje më pak. Lidhur me numrin e familjeve të komuniteteve joshumicë të lartcekura, numri nuk është 175, por është 190 familje. Ajo të pranishmit i informoi se me email i është drejtuar kryetarit të komunës dhe bashkëpunëtorëve të tij për të njëjtin problem vitin e kaluar dhe kryetari është përgjigjur menjëherë dhe ka bërë zgjidhjen e atij problemi.

**Kimeta Shok** – shtroi pyetje lidhur me mëditjet se a janë ndërprerë prapë pasi që për takimin e kaluar nuk na është bërë pagesa.

**Klaudia Mula** - tha se mund të jetë një gabim teknik i cili do të përmirësohet, mirëpo po ashtu lista nuk është definitive, kështu që kur të finalizohet lista do të jetë e përmirësuar. Ajo në vazhdim tha se nuk është e sigurtë që kjo listë do të kalojë komplet, mirëpo ne jemi duke punuar që të kalojë ashtu siç është.

**Nenad Miladinovic** – tha se meqë e kam thënë disa herë, po e përsërisë edhe njëherë ata të cilët i njoh unë e të cilët ndodhen në listë që marrin ndihma sociale prej tyre asnjëri nuk është në listën time, sepse unë vërtet kam shikuar që t'i përbledh familjet të cilat janë vërtet me kushte të vështira ekonomike, ndërsa ata që marrin ndihmë sociale nuk e di se si e kanë fituar të drejtën për ndihma sociale. Pas shumë diskutimesh, propozimesh dhe sugjerimesh znj. Misrada Behluli tha se në emër të të gjithë juve në Këshillin për Siguri i kam shfaqur të gjitha këto probleme ku zyrtarja nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ka thënë se për 4-5 muaj do të evitohen këto probleme pasi që kanë marrë kontejnerë dhe kamion të ri. Ajo në fund tha se vërtet po duken rezultatet ku deponitë nëpër periferi vërtet janë duke u zbratzur, si dhe situata është krejt tjetër me përmirësimë të dukshme.

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit  
Dr. Misrada Behluli



Faqe 5 nga 5